



Ftesë për EVP

Në kuadër të programit të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP), Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK) organizon sesionin online të EVP-së në platformën ZOOM që do të mbahet më **19 mars, 2021** me temë:

- Deklarimet vjetore për TAP, TAK, DO dhe OJQ;
Trajtimi i donacioneve, sponsorizimeve dhe shpenzimeve të përfaqësimit sipas ligjit aktual të Tatimit mbi të Ardhurat e Korporatave;
Trajtimi i grantit, subvencionit dhe donacioneve për TVSH, përfshirë regjistrimet në libra të TVSH dhe deklaratimet.

Ligjërues: Z. Sami Salihu – Drejtor në Dep. për Regjistrim dhe Shërbim të Tatimpaguesve në Administratën Tatimore të Kosovës

Regjistrohu në këtë [LINK](#) (jo më larg se data 18 mars 2021 deri në orën 16:30)

Data: 19 mars, 2021

Ora: 10:00 - 15:00 në platformën ZOOM

Ky seminar do t'iu sigurojë katër (4) orë të verifikueshme të EVP-së, që rezulton në pagesë totale prej **EUR 60.00**, ndërsa për Anëtarët Aktiv të ShKÇAK-së **EUR 30.00**.

Regjistrimi është i obligueshëm për të pranuar linkun për qasje në sesionin e EVP, linkun në fjalë do ta pranoni automatikisht menjëherë pas regjistrimit.

[KËTU](#) mund të gjeni Udhëzuesin e përdorimit të platformës ZOOM e cila mund të përdoret në kompjuter, laptop dhe telefon të mençur.

Pagesat duhet që të kryhen në njërën nga Llogaritë bankare si në vijim:

Banka: ProCerdit Bank
Xhrll. Nr. 1110161271000192

Banka Për Biznes
Xhrll. Nr. 1300271200089555

Për: ShKÇAK/SCAAK

Edukimi i Vazhdueshëm Profesional është i obligueshëm për anëtarët e ShKÇAK:

Kontabilistët dhe Auditorët e Çertifikuar duhet të vijojnë së paku **8 orë** të verifikueshme për vit kalendarik.

Auditorët Ligjor sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2019 për Licencimin e Auditorëve Ligjorë dhe Firmave Vendore dhe të Huaja Ligjore të Auditimit duhet të dëshmojnë (40) orë të EVP për vit kalendarik prej të cilave **24 orë** duhet të jenë të verifikueshme.

Auditorët e Çertifikuar që synojnë të aplikojnë për licencë "Auditor Ligjor" duhet të kenë parasysh se sipas UA Nr. 01/2019 kërkohen nga **24 orë** të verifikueshme në 3 vitet e fundit.

Auditorët e Brendshëm të Çertifikuar duhet të vijojnë së paku **8 orë** të verifikueshme për vit kalendarik.